

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-211/2014

Prishtinë,
10 Gusht 2016

Në çështjen juridike të:

G.D.

Berivojcë
Kamenicë

Paraqitësi i kërkesës/ Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KKKPK/D/R/231/2014 të datës 13 mars 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00465), pas shqyrtimit të mbajtur më 10 gusht 2016, mori këtë

AKTGJYKIM:

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e G.D. e paraqitur kundër Vendimit të KKPK-së nr. KKPK/D/R/231/2014, të datës 13 mars 2014.
2. Vërtetohet vendimi i KKPK-së nr. KKPK/D/R/231/2014, i datës 13 mars 2014, sa i përket kërkesës nr. KPA00465.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 7 mars 2007, G.D. (më tutje: pala ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së banimit për banesën që ndodhet në anën verilindore të ish ndërtesës së administratë të ndërmarrjes SH.A “Strezovce” në Kamenicë, në rrugën tek Komuna, Ndërtesa e ish Komitetit, me sipërfaqe prej 35 m² (më tutje: banesa kërkuar). Ai deklaron se e ka humbur posedimin mbi banesën e kërkuar për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999 me datën 1999.

2. Pala ankuese në AKP dorëzoi *inter alia*:

- ‘Vendim për banim të përkohshëm të punëtorit’, të datës 17 shtator 1997, nr. 92 (më tutje: vendimi për ndarje); sipas këtij vendimi, palës ankuese i ishte ndarë banesa që ndodhet në anën verilindore të ish ndërtesës së administratë të ndërmarrjes SH.A “Strezovce” në Kamenicë, në rrugën tek Komuna, Ndërtesa e ish Komitetit. Sipas paragrafëve 4 dhe 6 të vendimit për ndarje, pala ankuese do ta përdor banesën e kërkuar me një kontratë qiraje derisa të zgjidhet çështja e tij e banimit përmes një mënyrë tjetër adekuate sipas Ligjit për Marrëdhënie Banesore dhe akteve tjera normative;

Në deklaratat të drejtuara AKP-së në vitin 2011 dhe 2013, pala ankuese shpjegoi se ai kishte jetuar afër një fabrike të pllakave të qeramikes, ndërmarrja “Karaqevë”. Një ditë shtëpia e tij ishte çarë për shkak se një buldozer kishte qenë duke punuar afër shtëpisë së tij. Ai e kishte paditur ndërmarrjen “Karaqevë”. Punëdhënësi i tij, ndërmarrja SH.A “Strezovce” ia aprovoi atij si zgjidhje një banesë të përkohshme në ndërtesën e ish Komitetit. Pas luftës ai zbuloi se banesa e kërkuar ishte e zbrazët, dera e thyer dhe pjesërisht e marrë nga fqinji i tij.

3. AKP-ja e identifikoi pronën e kërkuar por asnjë palë tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së.
4. Sipas raportit të verifikimit, të datës 8 gusht 2008, AKP-ja nuk ka mundur ta verifikojë pozitivisht vendimin për ndarje pasi që dokumenti nuk ishte gjetur te ndërmarrja SH.A “ Strezovce” dhe ish sekretari i ndërmarrjes deklaroi se dokumenti nuk është valid, dhe nënshkrimi në dokument nuk buron nga personi i autorizuar i asaj periudhe.
5. KKPK-ja ne vendimin e saj vendosi që ta refuzojë kërkesën. Në arsyetimin e saj (paragrafët 10 dhe 46 të Vendimit Grupor), KKPK-ja vëren se pala ankuese kërkon konfirmimin e të drejtës së shfrytëzimit të banesës së kërkuar në bazë të një të drejtë të përkohshme të banesës. KKPK-ja më tej arsyeton se nuk ka prova se e drejta e përkohshme e shfrytëzimit ishte përtërirë apo vazhduar. KKPK-ja më tutje konsideron se një e drejtë thjeshtë e përkohshme e shfrytëzimit nuk mjafton për vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit mbi pronën e kërkuar që mund të kthehet sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
6. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 16 maj 2014.
7. Pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 13 qershor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese deklaroi se ai tani është duke jetuar në shtëpinë e dëmtuar pranë fabrikës së vjetër të qeramikave të “Karaqevë”. Atij i është ndarë banesa e kërkuar dhe kështu ka kaluar aty pasi e kishte marrë vendimin për ndarje. Ai kishte jetuar aty deri në ngjarjet e luftës në Kosovë dhe ishte kthyer në fshatin e tij të vjetër. Banesa e kërkuar është ende e zbrazët. Shtëpia e tij e tanishme mund të shembet tërësisht nga një termet i lehtë. Ai kërkon që të zgjidhet kjo çështje dhe i dorëzon të njëjta dokumente si para AKP-së/KKPK-së.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

9. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe prandaj është e pranueshme.

Meritat e ankesës

10. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thotë:

Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

(a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe

(b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

11. KKPK-ja arsyetoi se nuk ekzistojnë prova se e drejta e përkohshme e shfrytëzimit të banesës së kërkuar është përtërirë apo vazhduar. AKP-ja nuk ka mundur ta verifikojë vendimin për ndarje si të vërtetë.
12. Pala ankuese në ankesën e tij e kontestoi këtë konkludim të KKPK-së por nuk ka paraqitur prova tjera përveç atyre provave që tashmë janë paraqitur para AKP-së/KKPK-së.
13. Sipas vendimit për ndarje palës ankuese i është aprovuar e drejta e shfrytëzimit deri në zgjidhjen e çështjes së banimit të tij.
14. Prandaj, KKPK-ja vendosi drejtë se pala ankuese nuk ka të drejtë që ta shfrytëzojë banesën e kërkuar dhe e refuzoi kërkesën.

Konkludim

15. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3, nën-paragrafi c, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me të Ligjit 03/L-079 ,Gjykata Supreme vendosi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

16. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it